



SHIKOJ.COM

# PËRKTHIME



# KALIDASA

## Sakuntala

*(Dramë-fragment)*

*(Një oficer policie me dy policë nën urdhër të tij kanë zënë një peshkatar se i gjetën një unazë të kushtueshme).*

*Polici i parë (Duke rrahur njerinë e zënë) – Ore peshkatar! Pa na rrëfe: si të ra në duar kjo unazë, mbi faqe të së cilës është skalitur emri i Mbretit?*

*Peshkatar (Dridhet). – Mos më rrihni. S'e kam bërë atë faj që kujtoni.*

*Polici i parë – A je ti një Brahman<sup>1</sup> i larë, që Mbretit i është dukur se kjo unazë të përket e ta ketë falur?*

*Peshkatar. – Dëgjoni. Jam një peshkatar nga Sukravatara Tirtha.*

*Polici i dytë. – Kush të pyeti për fis e farën tënde?*

*Oficeri i Policisë. – (I flet policit). – O Suçak, lëre ta thotë tërë punë e tija. (I flet peshkatarit.) Thuana, ore: na i thua të gjitha. Mbajeni sa të flasë, po mos e rrihni.*

*Të dy policët. – A dëgjon, ore, apo jo? Bë si urdhëron oficeri.*

*Peshkatar. – Unë e mbaj fëmijën time duke zënë*

---

1) Brahman-i - mis i klasës së priftërinjve.



peshq me leqe e me pe.

*Oficeri (Tallet.)* – Të bukur punë bëke<sup>1</sup>

*Peshkatari* - Ç'faj kam, im zot? Ajo është puna e fisit tim; por dhe ndër ne janë shumë vetë zemërbardhë.

*Oficeri.* – Mirë. Rrëfena të ngjarën.

*Peshkatari.* – Një ditë zura një rohu (emër peshku) edhe i gjeta në bark këtë unazë me diamant. Po e dëftoja që të mund ta shes, kur erdhtë e më zutë. Aq faj kam. Tani bëni ç'tju urdhërojë detyra, a më vrisni a më lëshoni.

*Oficeri (I merr erë unazës.)* – Vërtet unaza bie erë peshku; prandaj, pa fjalë ka qenë në bark peshku. Ejani: le të dalim përpara.

*Të dy policët* – Le të vemi. (*Nisen të gjithë.*)

*Oficeri* – Suçak, qëndroni në këtë derë të madhe dhe mbajeni (peshkatarin). Do të rrëfej punën e unazës, dhe do të sjell urdhërin e Mbretit.

*Të dy policët* – Mirë. Çapni. (*Oficeri vete.*)

*Polici i parë* – O Januk (emër i policit të dytë) më hanë duart ta ther këtë vjedharak.

*Peshkatari* – Pse të më therni, kur s'kam faj?

*Të dy policët (Duke shikuar)* – Ja tek vjen oficeri vetë. Mbreti paska mbaruar shumë shpejt. Tani, peshkatar, a do të jesh i lirë, menjëherë, a do të të hedhim të të hanë qenat edhe shkabat?

*Oficeri kthehet.*

*Peshkatari (Dridhet.)* - Bobo! ç'më gjeti të mjerin!

*Oficeri* - ... është i lirë. Mbreti thotë se e njih punën e

---

1)Hindasit e kanë për mëkat të zënë peshq, prandaj peshkatarët shihen me sy të keq.



unazës; peshkatari s'ka faj fare; lëshojeni këtë çast.

*Polici i dytë* – Bindemi. Sot ky vjedharak shpëtoi nga të hyrët te Yama. *(E lëshojnë.)*

*Peshk.* *(Duke bashkuar duart)* – Ju vetëm ma shpëtuat jetën.

*Oficeri* – T'u hap fati i mirë, or djalë. Mbreti urdhëroi të të jipet çmimi i tërë unazës. Na, merr këtë. *(I jep peshkatarit një kuletë.)*

*Peshkatari* - Ah, tani s'e mbaj dot veten nga gazi!

*Polici i parë* – Pse ta mbash veten? Zbrite nga huri ku do të nguljim dhe i hipe elefantit.

*Polici i dytë* – Pse u gëzua Mbreti? Një unazë, sado, sado, nuk është nonjë punë e madhe.

*Oficeri* – Shkaku i gëzimit është edhe vlera e madhe e unazës; po më duket se shkaku i parë është se, kur e pa unazën Mbreti, i vate mendja në një vetë të dashur; se Mbreti, saqë është i qetë, kur pa unazën, zuri të dridhet edhe i ra zalia.

*Polici i dytë (Oficerit)* – Ahere zotëria jote i pëlqyet shumë Mbretit?

*Polici i parë* - Po me hir të këtij peshkatari. *(E shikon me sy të lig peshkatarin.)*

*Peshkatari* – Mos u zemëroni. Do t'ju jap gjysmën e kushtimit të unazës për të pirë alkool.

Të dy policët. – Ahere je miku i ynë. Akooli na pëlqen shumë. Eja, krah për krah, të vemi në treg. *(Largohen.)*



## Për Kasandrën

- Pjetrua i Ronsardit - frëngjisht: Pierre de Ronsard - lindur në 1524, vdekur në 1585, është një nga më të mëdhenjtë aethorët e Frëngjisë, aqë sa e pasemërojtin ca "Perëndi Ronsard". Këndoni këtu nga më të bukurat vjershat e tij, përkthuerë shqip fjalë për fjalë.

Vogëloshe, eja të shohim trandafilin, që këtë mëngjes kish përhapur fustanin e kuq në djell, në mos ka humbur - tani që ra nata - qindet e fustanit të kuq edhe faqet e saj që ngjajnë faqeve tëndeve.

Bobo! shiko qysh në pakë kohë vogëlushe, trandafille lëshoj bukurirat e saj, ho bobo! të bijen mbi dhe! O vërtet e ligë Naturë, me qenë që nja e tillë lule nukë duron më shumë se nga mëngjesi gjer në erësi!

Andaj, në më beson, vogëlushe, tani që vjen të tënd lulëzojnë në më të renë gjelbërin' e tyre, mblidh, mblidh gjelbërinë atë: Si edhe asaj lules, ashtu pleqësia ta ka për të shuar bukurinë tënde ...

*(Odes, Livre, I, 17)*

1897



## PJER DE RONSAR

### Një vjershë e Ronsard-it përmbi shqiptarët

Gjetmë një vjershë përmbi Shqiptarët të Ronsardit, i cili është më i madhi vat i Francës motshme. Këto vjersha i kish bërë për t'i vënë në krye të jetës madhe të Skënderbeut prej Lavardinit. Po i shpallim më poshtë ato vjersha të arta, e po i përkthejmë shqip këtu:

Shqipëria s'ka vetëm kuaj të mirë që rendin më shpejt se të tjerët; po ka edhe shumë luftëtarë trima, që lëvdohen se gjaku i trimit Aqileut rrjedh në dejt e tyre.

Kam për dëshmim Burham, që rrëzoi aq kështjella e më në fund pati varr kështjellën e vjetër të Argut; edhe Skënderbejnë, mundës t'Anadollakëve, të cilët kanë dëbuar ungjillin nga gjithë Azia.

O nder i shekullit tënd! O Shqiptar vdekjesjellës! Dora jote i mposhtoi njëzet e dy herë turqtë, e ishe tuta e hordhisë e kështjellave tyre!

Po me gjithë këto trimëri, do t'kish vdekur, sikur libri i dishëm i të dishmit Lavardin të mos kish fituar përsëri luftet e tua, duke forcuar vdekjen tënde.

1897



## LA BRYER

### Njeriu

-Për disa veta, ... dinakëria zë vendin e mendjes.

-Dinakët besojnë udobisht se edhe të tjerët janë dinakë; nuk mund të rrehen, edhe nuk rrejnë shumë kohë.

-Do ta shpërblej kurdoherë me pëlqim të madh veten time nga të qenët dinak, duke qenë i humbur e duke shkuar për i këtillë.

-Nuk ka gjë të cilën njerëzit duan ta mbajnë më tepër, edhe të cilën e kursejnë më pak se jetën e vetë.

-Të gjitha të ligat tona vijnë nga të mosmundurit të jemi të vetëm: andej lodra (kumari) llussat, shpërudhimi i tepër, vera, gratë, padija, keqthënia (la medisance), zilia, harrimi i vetes edhe i Perëndisë.

-Më të shumët njerëz përdorin të parën pjesë të jetës së tyre për të bërë tjetrën të mëshirshme.

-Në qoftë se jeta është e mëshirshme, është e vështirë të durohet; në qoftë e lumtur, është tmerr të humbet. Që të dyja një janë.

*Albania, 1906/6*



## Begatia

-Një njeri është i shëmtuar, i vogël nga shtati; edhe ka pak mendje. Dikush më thotë në vesh. Ka pesëdhjetë mijë lira të ardhura. Është punë e tija vetëm: dhe për mua s'do të jetë kurrë as me ligsh as më mirë. Në qoftë se nis ta shoh me sy të tjerë, e në mos qofsha i zoti të bëj ndryshe, sa i humbur qenkam.

-“Të bëhem i pasur” është një frazë aq e bukur, edhe e cila thotë një gjë aq të mirë, sa përdorimi i saj është i përbotshëm. Njihet në të gjitha gjuhët, u pëlqen të huajve edhe barbarëve, mbretëron në oborr edhe në qytet, ka shpuar manastiret edhe ka kapërcyer muret e abacive të njërit e të tjetrit seks; nuk ka vende të shenjtëruara ku të mos ketë hyrë, nuk ka shkretina vetmie ku të jetë e panjohur.

-Duke bërë kontratë të re e duke parë si argjendi po shemb përditë thesat e tyre, ca njerëz besojnë më në fund se kanë një kokë të mirë e pothuaj të zonjën të qeverisë.

-Për të fituar begati, e më tepër një begati të madhe, lispët njëfarë mendjeje. S'është as mendja e mirë, as e bukura, as e madhja as e larta, as e forta, as e holla: nuk di



pikërisht se cila mendje lipset, pres të na e mësojë kush.

-Ai është i pasur që merr më tepër se sa prish, ai është i vobek, shpenzimet e të cilit teprojnë të ardhurat.

-Akshcili me dy milionë të ardhura, mund të jetë çdo vit i vobek për gjysmë milion.

-Në mos harrove gjëkafshë për të bërë begatinë tënde, sa punë! Në harrove më të vogëlin gjë, sa pendim!

*Albania, 1906/5*



## Miqësia dhe dashuria

Dashuria lindet menjëherë, pa tjetër mejtim, nga karakteri a nga dobësia: një pikë bukurie na heq, na mban.

Miqësia, përkundra, bëhet pak nga pak, me kohë, me praktikë, me të marrëdhënë të gjatë. Sa shpirtomendje, sa mirësie zëmre, sa besë, sa shërbime e sa ëmbëlsie-sjelljesh nër miqtë, për të mbaruar në disa vjet shumë më pak se sa mbaron nganjëherë në një çast një e bukur fytyrë a një e bukur dorë!

Koha që shëndosh miqësit, dobëson dashurinë.

Shohim më shpesh një dashuri të flaktë se një miqësi të mbaruar.

Dashuria dhe miqësia përjashtojnë njëra-tjetrën.

Dashuria nis nga dashuria; dhe nga miqësia më e fortë nuk mund të shkosh përveç në një dashuri të dobët.

Dashuria që lindet në një çast, është më e gjatë për të shëruar.

Dashuria që rritet pak nga pak e me shkallë i shëmbëllen tepër miqësis për të qenë një besim i zjarrtë. Njeriu ndjen dashuri të vërtetë vetëm një herë, të parën; dashuriet që vijnë pastaj nuk janë aq të pavullnetshme.



Në qoftë se një e shëmtuar arrin të duhet, nuk mund të jetë përveç me një dashuri të pakufishme: do të jetë a nga një dobësi e çuditshme e të dashurit të saj, a nga hirera më të mpshehta e më të pamundshme se bukuria.

Sado delikat që në qoftë njeriu në dashuri, fal më shumë faje se në miqësi.

Të rrosh me armiq të sikur një ditë do të bëhen miqtë e tu, e të rrosh me miqtë sikur një ditë mund të të bëhen armiq, nuk është as pas natyrës së smirit, as pas rregullave të miqësisë. Nuk duhet të bëjmë armiq ata që të njohur më mirë, mund të hyjnë në radhë të miqve tanë. Miqtë duhen zgjedhur...

*Albania, 1906/4*



## VIKTOR HYGO

### Atyreve qi flenë

Zgjohi, mjaft turp! Derdhi kundrë obuzeve edhe kundrë kumbarave. Erdhi koha më në funt që vala të çfrynjë jashtë; miaft turp, mëmëdhetarë! Përvishni mëngët e këmishës. Burrat e andarsisë Francës derdeshin kundrë një-zet luftarëve mbretër. Copëtoni hekurat, thyeni burgjet tuaja! Çe! kini frikë prej këtyra maskarenj? prindrit tuaj qëndronin kundrë titanëve! Ngrihi! bëni hi edhe ordhinë edhe të zotnë! Kini perëndinë me vete, e priftin kundrër jush... S'kini armë? ç' ka të bënjë! Ti rëmbe çfurkun, tjetri çekanë, çkallmo hekurin e derës, mbush me gurë peqin' e flokës tënde! edhe bërtitni bërtimn' e shpresës! Shpëtoni – si të dredhur nga tërbimi – vëndin tuaj nga robëria, emrin tuaj nga turpi!

(*Les Chatiments, VI. Jersey, septembre 1853*)

*Albania, 1897, nr. 5*



## Mendime të zgjedhura

Francis Bacon

(1560-1626)

Më i madhi armik i arësyes, i urtësies, dhe i besimit, është Turma, shtazë e përshumë dhe e tmeruar, më e çuditëshme se Hydra. – *Sir Thomas Browne* (ne *Religio Medici*).

S'ka njeri i drejtë të gjukojë a të dëmnojë një tjetër, se s'ka njeri qi t'a njohë me të vërtet një tjetër. – *Sir T. Browne* (*ib.*)

Dimëri n'Englie mbaron në korrik dhe nis në gusht. – *Lord Byron*.

Djalli, në të gjitha *pallaskat* e tij ku mban shëgjetat, nukë ka për zëmërën një shëgjetë më të mprehtë se një zë t'ëmbëlë. – *Lord Byron*.

Në qoftë se ka një ferr (skëterrë) mbi dhé, ndodhet në zëmërë të një njeriu të mallëngjyer. – *Robert Burton*.

Ç' është një lundrë përveç se një burg? – *Robert Burton*.

× Më e mira pjesë e mësimit të ç'do njeriu, është ajo që i jep sicilido vetes së tij. – *Sir Walter Scott*.

× Nukë ka 'nonjë gjë me të vërtet të vlershme e cila



munt të blehet pa mundime dhe pa punë. – *J. Addison.*

Munt t'a bësh një gomar të fitojë Dije, po nukë munt t'a bësh dot të Mendojë. – *Mumford*<sup>1)</sup>

E djela përfshin ndryshkun e javës. – *J. Addison.*

Më e mira pjesë e bukuries është' ajo të cilën piktyra nuk është' e zonja t'a çfaqë. – *Francis Bacon.*

S'ka nonjë gjë të frikshme përveç se frika vetë. – *Francis Bacon.*

Nakari nukë ka të kremte ("Invidia festos dies non habet"). – *Francis Bacon.*

Janë shërime më të këqia se sëmundjet.

S'ka rezik më të math për gjë komp, se kur njerës dinakë shkojnë për t' urtë.

Shëro sëmundjen, po le të vdes' i sëmuri (këshillë ironike).

Një njeri i ri nga vjetët munt të jetë plak nga orat (sahatet), në mos ka humbur kohë.

Natyra është shpesh e mbuluar, nga nonjë herë e mundur, rallas e shuar.

Vallia është një çap i matur, si vargu është një folje e matur.

Ç'është' e vërteta, tha Pilati; edhe nukë deshi të presë pëgjigjen.

Nd' erësirë të gjitha ngjyrët duken si një.

Shkonte për një nga t' urtët ay qi u-përgjigj te pyetja, Kur të martohet njeriu? "Një burr' i ri të mos martohet akoma; një burr' i motuar të mos martohet fare".

Begatia është një shërbëtore e mirë, po një zonjë shumë e ligë.

1) Teksti englisht është: You may lead an ass to Knowledge, but you cannot make him Think.



## Edmund Burke

(1730-1797)

Është një nga lajthimet më të përgjithëshme dhe më vullgare të popullit, të kujtuarit se ata qi bërtasin më fort për kombin i a duan më tepër të mirën.

Ato gjëra qi nukë bëhen dot, nukë duhen dëshëruar.

Një demokraci e mbaruar është gjëja më e pa-turpëshme në botë.

Ata qi punojnë gjithënjë nukë munt t'a kenë gjykimin të vërtetë.

Tregimi është shkolla e njerëzies, dhe njerëst nukë do të mësojnë kurrë në nonjë tjetër shkollë.

Mesonjësi i math është Koha.

Miqësia e hidhëruar është nga nonjë herë aq' e ligë sa armiqësia e qettë.

X Nukë ndodhet nonjë dije pa vlerë.



## Seneka

Një poshtërsi qi del mbarë quhet virtut; të mirët bëhen robët e të ligjve; e dreqta është në forcë; frika e shtyp kanunin.

*Her. Fur., 251.*

Shpëtimi i të gjithëve është në spatë.

*Ib., 342.*

Mbretërimi përmi një vënt të huaj nuk është qëndrim i shëndoshë.

*Ib., 344.*

E para mieshtëri për të qeverisur është të muntsh të durosh zilinë.

*Ib., 353.*

Ay qi duron t'a shtrëngojnë, nukë di të vdesë. (Lat. *Cogi qui potest, nescit mori.*)



*Ib.*, 426.

x Cilindo që në pafsh të vuaj, dij-e se është njeri.

*Ib.*, 463.

x Në punët e vogëla ka qetim të math.

*Ib.*, 469.

Frika e luftës është më e keqe se lufta vetë.

*Ib.*, 572

Ç' do mbretëri është nënë një mbretëri më të rëndë.

*Ib.*, 614.

x Ç'ka qënë e ashpër për të duruar, është e ëmblë për të kuituar.

*Ib.*, 656.

x E para horë qi na dha jetën, na e mer. (Ky mendim i thellë i Senekës do me thënë që, me të lindur njeriu, i shkurtohet jeta. Për tregim, në ka për të rojtur gjithëgjithë 50 viet, një javë pas lindies do t'i kenë mbetur vetëm 49 viet e 51 javë për të rojtur).

*Ib.*, 874.

Më e madhia e mirë për një mbretëri është kur populli jo vetëm është i shtrënguar t'i durojë të bërat e zotit, po dhe t'i lëvdojë.

*Thyest.*, 211.

Le të dojë mbreti punë të ndershëme, (dhe ahere) sicilido do të dojë ç' do ay.

*Thyest.*, 213.

x Kij-e për turp t'i bësh të ligë një vëllai, qoft' edhe i lik.

*Ib.*, 219.

Mbret është kë nukë e trëmbi gjë. Mbret është kush nukë lakmoj gjë. Këtë mbretëri munt kushdo te i a falë vetes.



- Ib.*, 388.
- ✓ Sa do të mpshihet, rëfeket nga fytyra zëmërimi.  
*Hipp.*, 363.  
Nukë ka ditë pa trishtim. *Troad.*, 77.
- ✓ Ay qi, duk' e pasur në dorë, nukë e ndalon një të ligë  
(dëfton se) e do.  
*Troad.*, 291.
- ✓ Atë që s' të ndalon kanuni, të ndalon turpi t'a bësh.  
*Ib.*, 334.
- ✓ Fati munt të na marrë ç' kemi, jo ç' menjtojmë.  
*Med.*, 176.  
Në gjukon, pyet; në qeveris, urdhëro.  
*Ib.*, 194.  
Të vërtetën moti e zbulon.  
*De Ira*, II, 22.  
Disa të rena kanë fytyrën e së vërtetës.  
*De Ira*, II, 22.
- ✓ Fajet e të tierëve i kemi përpara syvet, t'onat prapa.  
*Ib.*, II, 28.
- ✓ Më e madhia pjesë e njerësve u-zëmërohet jo fajeve  
po fajtorëve.  
*Ib.*, II, 28.
- ✓ Jeta, në di t'a përdorsh, e gjatë është.  
*De brevit. vit.*, 2.  
As arësye duron as dreqtësi njih as lutie ndëgjon një  
popull i urët.  
*Ib.*, 18.



## Tacitus

“Viedhies, vrasies, rëmbimit i thonë me emëra të rena qeverim, e atie ku bëjnë shkreti thonë se bëjtin paqe”.

*Agricola, XXX.*

“Sa më i kalbur është një shtet, aqë më tepër kanune bën”.

*Ann., III, 27.*

“Dëshiri i urdhërimit është më i flaktë se të gjithë dëshirët e tiera”.

*Ibid., XV, 53.*

“E dinte se gjakësitë më të mbëdha (*summa scelera*) nisin me rezik, mbarohen me çëmim”.

*Ib., XII, 67.*

“Fama nukë lajthitet gjithënjë; nonjë herë zgjeth edhe mirë”.

*Agricola, IX.*

“I till’ ish shteti i mendieve sa këtë tradhësi aqë të ligë dia e kudzuan, shumë e deshnë, të gjithë e duruan”.

*Hist., I, 28.*

“Nuk i zihet kurrë miaft besë një force, kur është forcë e tepërt”.

*Ibid., II, 92*



“Ndyrësitë (vitia) do të jenë sa të jetë njeriu: po s’janë të gjithënjëshme, edhe godit që përpeshohen me punë më të mira”.

*Ib., IV, 74.*

“Më e liga farë armiqësh, lëvdimtaret”.

*Agricola, XLI.*

“Të gjitha, o pleq, sa besohen fare të motëshme, kanë qënë të rea”.

*Ann., XI, 24.*

“Mbarojmë më shumë punë me urtësi se me forcë”.

*Ann., II, 26.*

“Një paqe pa nder më mirë le të këmbehet me luftë”.

*Ib., IV, 27.*

“Aqë më tepër çkëlqente, sa më pakë dukej”.

*Ib., IV, 76.*

“Koha për t’ardhur i jep ç’ do njeriu laftin qi i përket”.

*Ib., IV, 35.*

“Të nisur të ndxehtë, të mbaruar të ftohtë”.

*Ib., IV, 17.* (Kio fialë nukë përkthehet dot shqip. Latinisht është: *Acribus inittis incurioso fine*, - fialë për fialë: Nisie e ashpër, funt pa kuides.)

“Të pa-lejëshmet pëlqejnë”.

*Ib., XIII, 12.* (Latinisht: *Praevalent illicita*, punët qi janë të ndaluara kanë më tepër fuqi.)

“Nakari edhe frika i pengojnë më të shumat qëllime të mira.”

*Ib., XIII, 53.*

“Dëshiri mos pësojnë gjë për vete të tyre, është kurdoherë armiku i qëllimeve të larta”.

*Ib., XV, 50.*



“Helmi më i lik i ç’do miqësie së vërtetë është *sicilido* *dobien e tija*”. *Hist.*, I; 15.

“Liria edhe kafshëve t’ egëra qi janë pa gjuhë u është dhënë”. *Hist.*, IV, 17.

“Më i ashpëri nakar është i të afërmve”.  
*Ib.*, IV, 70.



## Çpifja

*Calomniez, calomniez! il en restera toujours quelque chose.* (Beaumarchais, Barbier de Seville): Çpifni, çpifni! diç' ka për të mbetur gjithënjë nga çpifja.

*Audacter calumniare, sepmer aliquid haeret.* (Bacon): Nga të çpifurit me kuxim gjithënjë diç' ngjitet.

*Calumnies are answered best with silence.* (Ben Jonson): Të çpifurave më e mira përgjigje është heshtja. X

*Carmina sprete exolescunt; si irascare, agnita videntur.* (Tacitus, Ann. IV, 34): Satirat e mos-vëna 're bien; në qoftë se zëmërojnë, duken sikur njihen të vërteta.

*Homines qui gestant, quique auscultant crimina,  
Si meo arbitrato liceat, omnes pendeant,  
Gestores linguis, auditores auribus.*

(Plautus, Pseudolus, I. 5).

Njerëst qi përhapin dhe ata qi dëgjojnë të çpifura, sikur të pëlqej mëndia ime, të gjithë duhej të vëshin, çpifaraktë nga gjuha, dëgjonjësit nga veshët. X

*Difficilem oportet aurem habere ad orimina.* (Publius Syrus): Duhet të çpifurave t'u vëmë veshin nga dalë.

.... *Back wounding calumny desmordre une opinion qu'elles*



*eussent conceue en cholere* (Montaigne, Essais<sup>1</sup>, II, 32):

1. Éd. Louandre.

Kam njohur qindra gra, të cilat munt t'i bëjë më leht të kafshojn hekur të skuqur se sa të hiqin dorë nga një mendim që të kishin zënë në zemërim e sipër.

*De laides universellement il n'en est non plus que de belles* (ID., ib., III, 3): S'ka gra fare të shëmtuara as fare të bukura.

*La rigueur des maistresses est ennuyeuse: mais l'aysance et la facilité l'est, à vray dire, encores plus* (ID., ib., II, 15): Mrovjtësia e të dashurave të mërzit; po e vërteta është që lehtësia dhe dobësia e tyre të mërzitin edhe më tepër.



## Gratë

*Un beua visage est le plus beau de tous les spectacles; et l'harmonie la plus douce est le son de la voix de celle que l'on aime* (La Bruyère, Les Car., III): Një fytyrë e bukur është më e bukura e të gjitha pamjeve; dhe harmonia më e ëmblë është tingëllimi i zërit t'asaj që duam.

Les femmes sont extrêmes: elles sont meilleures ou pires que les hommes (ID., ib.): Gratë janë të pëртејme<sup>1</sup>: janë më të mira a më të liga se burrat.

*Les hommes sont cause que les femmes ne s'aiment point* (ID., ib.): Burrat janë shkak që gratë s'duan njëra tjetrën.

*L'on peut être touché de certaines beautés si parfaites et d'un mérite si éclatant, que l'on se borne à les voir et à leur parler* (ID., ib.): Munt zëmëra të qëllohet prej ca bukuriesh aqë të mbaruara dhe prej një meritimi aqë të çkëlqyer, sa kënaqet t'i shohë njeriu dhe t'u flasë.

*The whitest virtue strikes.* (Shakespeare, Measure for Measure, III, 2): E çpifura qi plagos prapa kurrizit, godit edhe më të bardhin virtyt.

*Be thou as chaste as ice, as pure as snow, thou shalt not*

1) Do m.th., dalin pëртеј masës.



*escape columny.* (Shak., Hamlet, III. 1). Ji aq' i kthiellt sa akulli, aq' i kulluar sa bora, nukë ke për të shpëtuar nga çpifja.

*Nihil est...*

*Quin male narrando possit depravarier.*

(Terentius, Phormio, IV. 4)

S'ka gjë qi të mos muntje të duket e ligë, në u-rëfektë liksh.

*Albania, 1906/8*



# HAJNRIH HAJNE

(1797 - 1856)

## Mendime të natës

(Viersha gjermanishte, të përkthyer shqip)

Natën, kur më vete mëndia te Dheu ku u-linda<sup>1</sup>, shpejt më del gjumi; nukë munt më t'i mbyll sytë, e lott' e mia më riedhin të ndxehta.

Viettë vijn' e shkojnë! Që kur s'kam parë nënën, dy-mbë-dhietë viet kanë kaluar; dëshira edhe malli po më riten për ditë.

Dëshira edhe malli po më riten<sup>2</sup>. Plaka e dhëmshur si kur më ka bërë magji<sup>3</sup>; gjithënjë te plaka e kam mëndien, te plaka e mirë Perëndia i shtoftë jetën!

Plaka e mirë më do aqë, e në letrat që më shkruan, shoh si i dridhet dora, sa fort e turbulluar është zëmëra e nënës.

Nënia s'më del nga mënttë. Dy-mbë-dhietë viet kanë

---

1) "Denk ich an Deutschland in der Nacht", fialë për fialë: "Kur mejtonj Gjermanine natën", - po në vënt të Gjermanisë vumë "vëndi ku u -linda" që të meret vesh më mirë prej Shqipëtarëve. Bëjtin një ndryshim t'atillë edhe në viershat e fundit.

2) "Mein, Sehnen und Verlangen wächst".

3) "Die alte Frau hat mich behext", f. Per f.: E vietëra Zonjë më ka bërë magji.



shkuar, dy-mbë-dhietë viet kanë fluturuar që kur s'e kam shtrënguar mi zëmër t'ime.

Atdheu do të qëndrojë për jetë, është një vënt me kurm të shëndoshë e të fortë; me dushket e tij, me shtogjet<sup>1</sup> e tij, do t'a gjej kurdoherë.

S'do t' më digjej aqë zëmëra për atdhenë, sikur të mos m'ish atje nënia. Atdheu nukë do të vdesë kurrë, po plaka munt të vdesë.

Që kur e lashë vëndin shumë ndër ata që doja, kanë zbritur në varr – kur i nëmëroj, më pikëllon gjak zëmëra.

E duhet t'i nëmëroj. Me numër, më shtohet edhe të vojturit, e më duket se të vdekurit më rrëkellejnë në krahëruar. Perëndia qoft' e lëvduar më largohen nga mëndia.

Perëndia qoft' e lëvduar! Nga dritësoria hyn një rreze djelli. Shoqia ime vien, e bukur si mëngjezi i parë, e me të qeshur të hieshm të saj largon mendimet e zeza.

*(Zeitgedichte, - XXIX Nachtgedanken).*

---

1) "Mit seine Eichen, seinen Linden".

"Linde" gj., "tilleu!" fr., vallë shqip si thohet? Vumë fialën "shtok" ndonëse ka tiatër rrëfim (gh.flieder).



## Margaritarët e Perandoreshës Elizabetë

*(Duke kënduar viershat e H.Heine-s, mëndia do e mos i vete njeriut te fatzeza Perandoreshë Elisabeta e Austrisë qi e kish viershëtorin e math në aqë pëlqim sa i kish ngrehur një Shtat mermeri në Kështiell të saj në Korfuz. – Po përkthejmë këto radhë të bukura (vallë a të vërteta?) nga një gazetë inglize:)*

Kur i vate mandata e zezë e vdekies së dialit të vetëm të saj (Kryeduka Rudolphi), Perandoresha kish në qafë një rreth margaritarësh të mëdhenj me kushtim të paçmuar. Kur ra nata, kopilia vuri re, me tmer, se margaritarët kishin humbur fare çkëlqimin e tyre; i a kallzoi me ngadalë Zonjës së Lartë së saj, e cila s' besoi as deshi t'i vërë veshin.

Ca javë më tutie, Perandoresha kërkoi margaritarët e saj e briti çudie kur hapi kutinë. Qaforia nukë ngjante fare me margaritarët e çkëlqyer e të çuditëshm q'ishin që moti. "Nuk është qaforia ime," tha me mëri. Po mësoj se, si miq të vietër e të besës, të dashurit margaritarët e saj ishin veshur në zi bashkë me zonjën e tyre. Pyeti



gjithë xhevahirxhinjt' e dheut që të përpiqen t'u japin  
çkëlqimin e parë margaritarëve të saj, po kot!

Më në funt, një mësimitar kimie n'Universitet të  
Vienës, i tha Perandoreshës se e vetëma udhë për të  
ndritur përsëri margaritarët, ish t'i klliste e t'i lënte në  
det sa kohë të muntte. Ashtu bëri. Një ditë, bashkë me  
një monk (gr. Monaskos, kallojeros) vetëm,  
Perandoresha vate me një lundrë më nj'anë deti në  
Korfuz, e, me ndihmë të tij, e mpshehu qaforen në një  
vrinë guri ku hidheshin valat, duke e vënë në be që të  
mos rëfente.

Bobo! sa tepër u-mbajt e mpshehta! se, duke mësuar  
fundin e tmeruar të Zonjës së madhështueshme, At  
Ambrozi (kështu cë emri i monkut) ra për chast mbë  
dhe i vdekur, kurdo të nistë të këndonte meshën. Dhe  
tani që të dy flenë gjumin e varrit, e qaforia e  
margaritarëve ri larg syve të njerëzisë në kush e di ç'gur  
të rahur prej valave; dhe pishkëtorët e Korfuzit përpiqen  
kot t'a gjejnë...

*Albania, 1902, Nr. 1*



## Mbreti Harold Harfagar

Mbreti Harold Harfagar rron në fund të ujërave te e Bukura e Detit, vjetët vijnë e shkojnë.

I lidhur nga magjitë e nga hutimet e së Bukurës, nuk mund as të rrojë, as të vdesë; po bëhen dyqind vjet që vuan në këtë zgjedhë të ëmbël.

Kryet e Mbretit çlodhen mi gjunjë të Zonjës së dhemshur e nuk nginjet kurrë së pari dashurisht syt' e saja.

Leshrat e arta të tij u zbardhën si ergjendi, kockat e faqeve i janë hedhur nën cipë të verdhë, trupi i tij është i fishkur e i thyer.

Nganjëherë shkulet nga ëndërra e dashurisë së tij, kur valët shfryjnë përsipër kokës së tij e dridhet pëllaci i tij i qelqtë.

Nganjëherë i duket se dëgjon përsipër valëve nëpër erë që fryn duke shkuar, kushtrimin e armiqve; ngrihet me një hop, dridhet gazi, zgjat krahun, po krahu i bie me rrëmbim.

Nganjëherë i duket se dëgjon përsipër tij detarë që këndojnë e lavdërojnë në këngët e tyre trimëritë e Mbretit Harold Harfagar.

Ahere mbreti lëngon, vajton në fund të zemrës së tij. Por e Bukura e Dheut unjet shpejt mi të e e puth duke qeshur.

*"Albania", 1902*



## Dhembje

*(Und wussten's die Blumen, die kleinen)*<sup>1</sup>

Dhe sikur lulet e vogla të dinin sa thellë është plagosur zemra ime – do të qanin bashkë me mua – që të më shëronin dhembjen.

Dhe sikur bilbilat të dinin – sa i trishtuar e sa i sëmurë jam - do të tingëllonin me gëzim – këngë ngushëllore.

Dhe sikur dhembjen time – ta dinin yjzët e artë, - do të vinin nga lartësia e tyre – e do të më flisnin për ngushëllim.

Të gjithë ata s'e dinë, - veç një e di dhembjen time: - Ajo vetë ma grisi – ma grisi zemrën.

*(“Libri i Këngëve” – Intermexo lirike)*

---

1) gjerm. – Dhe të voglat lule u vyshkën



## × E bija e mbretit edhe trëndafijt

Ish një mbret, ish një mbretëreshë. Kishin një vajzë të vetme. Dhe vajza ish e bukur dhe e mençur. Dhe aq e gëzuar, sa qeshte ditë për ditë me shumë herë se sa kokërrza ka shega.

Pallati i mbretit, kopshti i pallatit, shelgjet e kopshtit, fletët e shelgjevet tundeshin nga diljin yjtë, kërciste gazi i së bijës së mbretit. Dhe kur bëheshin mbledhje, darkë, festa, në pallat, të qeshurit e princeshës ish më i hijshmi i shkëlqimevet. Qeshte shumë, po qeshte bukur. S'kish një të qeshur të marrë e të sëmurë, po një të qeshur të ri e të dashur: tingëllimi i zilevet në qafë të shqerravet në verë; të pëshpëriturit e erës nëpër gjethe.

Po një ditë vdiq mbretëresha, dhe princeshës iu mvrojti pak buza. Një natë vdiq mbreti, dhe princeshës iu pre gazi. Dhe pak kohë pastaj goditi që ra zjarri në pallat dhe e dogji. Dhe princesha, e mbetur e varfër e vetme, ndjeu për të parën herë trishtimin.

Me zemër të fryrë nga psherëtimet, e bija e mbretit u vesh si fshatare, mori një stap në dorë, dhe dolli nga dheu i t'et duke qarë.

Loti i parë që derdhi mbiu mbë dhe menjëherë, dhe



dolli një rrënjë trëndafili e gjatë, e bukur, me degë shumë. E kudo që derdhte lot princesha, mbijin trëndafij. E ngaqë të qarët e saj s'kish pushim e të ecurit e saj s'kish qëndrim, trëndafijt mbijin në të katër anët e botës.

Një ditë princesha, e lodhur e e trishtuar më tepër se ditët e tjera, arriti në qytet të Ispahanit, në Persi. Atje qëndroi në një gur, dhe qau tri ditë; e prandaj, Ispahani është qyteti ku janë më të bukurit trëndafij të botës.

Në fund të ditës së tretë, princesha e mjerë vdiq dhe trupi i saj u kthye dhe u bë një trëndafil, degët e të cilit duallën më sipër se gjithë të tjerët.



## U. SHEKSPIR

### Harrim

*(Blow, blow, thou Winter Wind)*<sup>1</sup>

Fry, fry, ti erë e dimrit; s'je aq' e ligë sa harrimi i njeriut; dhembti yt s'është aq i mprehtë, se nuk duket, sado që fryma jote është e ashpër. Hoi-ho! Vërshëlle, hoi-ho, nëpër lis të gjelbër: miqësia e madhe është gënjeshtër, dashuria e madhe s'është përveç marrëzi: pra, hoi-ho lis! Kjo jetë është shumë e bukur.

Ngrini, ngrini ju re të ashpra, se nuk shponi aq fort sa mirëbërat e harruara: sado që i bëni ujërat të bien, maja juaj s'është aq e mprehtë sa moskujtimi i një miku.

Hoi-ho! Vërshëlle, hoi-ho nëpër lis të gjelbër: miqësia e madhe është gënjeshtër, dashuria e madhe s'është përveç marrëzi: Hoi-ho, pra: Kjo jetë është shumë e bukur.

*(English Songs and Ballads, f. 80)*<sup>2</sup>

*Albania, 1902*

1) (përkth.) Fryj, fryj, ti er' e dimrit.

2) Këngë dhe balada angleze



P.B. SHELI

## Vajtim

*(O world! O life! O time!)*

O botë! O jetë! O kohë! në shkallë të fundme të të cilave po shkel, duke u dridhur tek ajo ku kisha qëndruar më parë, - kur do të kthehet prapë bukuria e prendverës suaj?

Jo më, - oh, kurrë më!

Larg ditës e larg natës, një gëzim ka fluturuar: Prendvera e njomë, edhe vera, e dimri plak të dobëtën zemrën time s'do ta tundin më me atë dhembkë të ëmbël.

Jo më, - oh, kurrë më!



## F. SHILER

### Prendverës

*(Willkommen, Schoener, Juengling)*<sup>1</sup>

Mirserdhe, vashë e bukur! Ti e mirë e natyrës! Me shportën tënde plot me lule, mirserdhe në fushë!

Qeh, qeh! Na erdhe prapë! Edhe je aq e hijshme e aq e dashur! E na gëzohet zemra, të dalim të të presim.

A e kujtove edhe këtë herë të dashurën time? Ah, lumja ti, kujtoje, pra! Ahere më donte e dashura e prapë më do!

Për të dashurin kërkoja shumë lule, e tani të kërkoj prapë e prapë po më nep.

Mirserdhe, vashë e bukur! Ti e mirë e natyrës! Me shportën tënde plot me lule, mirserdhe në fushë!

*(Schiller's Gedichte)*<sup>2</sup>

*Albania, 1902*

---

1) Mirë se vini, bukuroshe e djelmoshe

2) Vjersha të Shilerit



## Fragmente nga "Alkasini e Nikoleta" <sup>1</sup>

*(Këngë-prallë Frënge e Shekullit XIII. Kthyer-Shqip)*

1.

Kujt i k'ënda për një vjershë  
Që rëfen ç'pengime gjetnë  
Alkasini me Nikoletën  
Dy të hieshm e të vegjël,  
Ç'mundim hoqi djal'i mjerë,  
Si lëftoj ky trim me fletë

Për të flladëtën miqeshë?  
Kënga është e ëmbl e kthjelltë,  
Fjala është e mir' e ndershme:  
S'ka njeri në këtë jetë,  
Sa-do i sëmur' i prerë,  
I cili posa t'a ndjejë  
Të mos ngjallet me një herë  
E të ngrihet të dëfrejë,  
Aq është e kannshme.

---

1) Bëhet fjalë për Alkasinin e për Nikoletën



2.

*Tani thon' e tregojn' e rëfejnë*

Që konti Bolgar i Valencës i bënte kontit Garin të Belkares një luftë aqë të madhe e aqë të çuditshme e aqë vdekje-sjellëse, sa s'la ditë pa u-sulur gjer në dyert e në muret e në lloset e qytetit, me një qint kalorës e me dhejtë mij' trima këmbës dhe kaluar; edhe i digjte mallin edhe i shkretonte vëndin edhe i vriste njerëzit.

Konti Garin i Belkares ish plak edhe i dobët edhe i shkuar nga moti. S'kish tjetër trashëgonjës, bir a bijë, veç se një djalë të vetëm. Ky ish kshtu siç do t'ju rëfej. Alkasin e kish emërin zoti i ri; ish i bukur e i hieshm e i gjatë edhe i bërë mirë nga shalët e nga këmbët e nga trupi e nga krahët. Leshërat i kishte të verdha e të dredhura hollë edhe sytë të ndritura e të qeshura edhe fytyrën të bardhë e të hequr edhe hundën të plottë e të drejtë, edhe ish i mbaruar së gjithash aqë sa s'i gjeje dot të metë. Po dashuria, e cila del kudo mundëse, e kish kapur, aqë sa s'donte as kalorës të jetë as armët të ngjeshë as në patalok të dalë as të bëjë detyrën e tija. I ati dhe e ëma i thoshin:

Biro, ngjish armët dhe hip-i kalit dhe mpro vëndin tënt dhe ndih njerëzit e tu. Në të pafshin në mes tyre, do të mprojnë më mirë trupet e tyre dhe kamjen e tyre edhe vëndin t'ënt e t'onin.

Tatë, i a bën Alkasini, ç'jan' ato që thoni? Mos më faltë gjë Perëndia, kur të bëhe (...)

Biro, i a bën i ati, kjo s'bëhet. Nga Nikoleta hiq dorë; ajo është një skllave e prurë nga një vënt i huaj, edhe e bleu viskonti i këtij qyteti nga Arapët edhe e solli në



këtë qytet, edhe e riti dhe e pagëzoj dhe e bëri si të bijën e tij, edhe tani j'a ka për të dhënë nonjë trimoshi i cili do të nxjerë bukën e saj me nder. Ajo s'është për ty; e në daç të marsh grua, do t'të jap të bijën e nonjë mbreti a konti. S'ka njeri në Francë, sado i pasur, bijën e të cilit të mos e marsh po e deshe.

Ah, tatë, j'a bën Alkasini, po ku ka nder miaft të lartë në botë i cili, po t'i bëhet Nikoletës, miqeshës s'ime ëmbëlshes, të mos jetë nder i përdorur mirë? Sikur t'ish perandoresh' e Stambollit a e Gjermanisë a mbretëresh' e Francës a e Inglisë, do t'ish pakë gjë për të, aq' është fisnike dhe e sjellë dhe e urtë dhe plot me vetia të mira.

### 3

#### *Tani këndojnë*

Alkasini në Belkare  
Në një kullë ron të lartë  
I ati s'e lë të marë  
Nikoletën flokë-artë,  
Po njeri dot s'mund t'i ndajë.  
E ëma zuri t'i flasë:  
"Pa shiko! ç'bën kshtu, o djalë?  
Nikoleta është një vajëz  
Gazmore, vërtet, e pashëm  
Po e vjedhur në Kartagë  
Dhe e shitur posi skllave.  
Me që do grua të marësh,  
Prej një dere mer të lartë!"  
"Nëno, unë s'roj pa marë



Nikoletën zëmër-bardhë;  
Trup' i saj, fytyr' e flladët  
Shpirtin t'im m'a bëjnë flagë:  
Ësht aq' e mallshme!”

4.

*Tani thon' e rëfejn' e tregojnë.*

Kur pa konti Garin e Belkares që s'e largonte dot Alkasinin nga dashuria e Nikoletës, thirri viskontin e qytetit, (...)

Në burg vunë Nikoletën  
Në një odë me kubënë  
Të bërë siç di një mjeshtër  
Me piktura çudi shkruar  
në piktura dhe ndriçuar  
Në dritore të mermertë  
U-pshtet vajza e shkretë.  
Si flori e kishte leshtë,  
Vetullat një vij' e lehtë,  
Faqia lule të verës.  
Më të bukur s'pe në jetë  
Nëpër kopsht shikoj të gjelbër,  
Trëndafilin pa të çelur  
Edhe zogjtë këngë-kthjellt  
Si jetime ndjeu veten.  
“Ah oji! Se ç'jam e mjerë!  
Pse më kanë në burg shtjerë?”